

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6162
E mërkurë, 11 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Në Kosovë edhe pesë
viktima dhe 596 raste
të reja me Covid-19



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KADRI VESELI ËSHTË PARAQITUR PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

VESELI DEKLAROHET I PAFAJSHËM PËR TË GJITHA PIKAT E AKTAKUZËS



Ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, Kadri Veseli, ka deklaruar pafajësi për akuzat e Dhomave të Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para kësaj gjykatë, ai ka thënë se me bindje të plotë mohon të gjitha pikat e aktakuzës së ngritur ndaj tij. "I

nderuar gjykatës, i dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të deklaroj me bindje të plotë, se jam i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës", ka deklaruar Veseli. Avokati i Veselit, Ben Emmerson, i cili në këtë seancë është lidhur nëpërmjet

videovjeggës të internetit, ka reaguar ndaj procesverbaleve të gjykatës në të cilat thuhet se ai është arrestuar. Avokati ka treguar se Veseli është paraqitur në Hagë vullnetarisht, duke shtuar se do ta kërkojë lirinë e tij të parakohshëm

VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR PAJTOHEN PËR TREG TË PËRBASHKËT DHE PËR POLITIKA TË GJELBRA

HOTI: MOSNJOHJA NGA SERBIA DHE BOSNJA, PENGESË PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK RAJONAL

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në takim virtual të Samitit të Sofjes, ka thënë se pengesë për zhvillim të plotë të

potencialit të bashkëpunimit ekonomik rajonal është mungesa e normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis vendeve të

rajonit, veçanërisht mungesa e njohjes së Kosovës nga Serbia dhe nga Bosnjë e Hercegovina

OPINION

PRESIDENTI I RI JOE BIDEN
DO TA NXISË ZHVILLIMIN E
DEMOKRACISË F. 11

Shkruan: Prof. Ass.
Dr. Sabri KIÇMARI



AKTUALE

MBI 36 MILIONË TË SHËRUAR
NGA COVID-19 NË MBARË BOTËN F. 2

RRGK-ja KËRKON INTEGRIMIN E
PERSPEKTIVËS GJINORE NË
TEKSTET E REJA SHKOLLORE F. 6

KOMUNA E PRIZRENIT NDAN DRU
PËR NGROHJE PËR 700 FAMILJE F. 10

EKONOMI



MINISTRI ABRASHI VIZITOI
AEROPORTIN PËR TË PARË
ZBATIMIN E MASAVE
ANTI-COVID F. 8

RUKIQI: MBI NJË MILIARD EURO
RËNIA E QARKULLIMIT NË
EKONOMINË E KOSOVËS F. 8

KULTURË

MIQËSORJA KUNDËR
SHQIPËRISË, PARAPËRGATITJE
PËR KUALIFIKUESET E
BOTËRORIT 2022 F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbi 36 milionë të shëruar nga Covid-19 në mbarë botën

NJU JORK, 10 NËNTOR - Numri i të shëruarve nga Covid-19 në mbarë botën ka tejkaluar shifrën 36 milionë. Sipas faqes së internetit "Worldometer", e cila përpilon të dhënat mbi pandeminë, gjithsej 36 011 650 persona në botë janë shëruar pas infektimit me

virusin. Numri më i madh i të shëruarve është regjistruar në Indi (7 957 206), ndërsa pas saj radhiten ShBA-ja (6 533 916), Brazili (5 064 344), Rusia (1 335 141), Argjentina (1 062 911) dhe Kolumbia (1 047 017). Ndërkaq, në Turqi, numri i të shëruarve që prej 9 nëntorit ka

arritur në 340 286. Që nga shfaqja për herë të parë në Kinë në dhjetorin e kaluar, koronavirusi është përhapur në mbarë botën, duke infektuar mbi 51 milionë njerëz dhe duke shkaktuar mbi 1 milion e 268 mijë të vdekur.



Niveli i ndotjes së ajrit në Itali, në s'përputhje me rregulloret e BE-së

ROMË, 10 NËNTOR - Italia ka shkelur "në mënyrë të vazhdueshme" rregullat e Bashkimit Evropian kundër ndotjes së ajrit, ka thënë Gjykata Evropiane për Drejtësi të martën, duke mbrojtur veprimet ligjore të Brukselit kundër Romës. "Vlerat ditore dhe ato vjetore të grimcave PM10 janë tejkaluar në baza të rregullta" në zonat e theksuara nga Komisioni Evropian, në një procedurë të nisur dy vjet më parë, ka thënë gjykata në një deklaratë. Përveç kësaj, "Republika italiane ka



dështuar që të miratojë masa të reja", që kërkohen nga Direktiva e BE-së për Kualitet

të Ajrit, e cila tenton ta zvogëlojë ndotjen e ajrit në Evropë.

PM10 u referohet sasisë të grimcave që ndotin ajrin në mikron për metër kub. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se grimcat ndotëse të ajrit, më të vogla se 10 mikronë mund të arrijnë në mushkëri dhe ato më të vogla se 2.5 mikronë mund të shkaktojnë shkallë më të lartë të vdekshmërisë për shkak të kancerit në rrugët e frymëmarrjes dhe ato kardiovaskulare. Agjencia Evropiane e Ambientit vlerëson se 374 000 vdekje të parakohshme mund

të raportohen në baza vjetore si pasojë e ajrit të ndotur në BE. Përveç Italisë, edhe disa shtete të bllokut evropian janë duke u vëzhguar nga Brukseli për këtë çështje. Gjykata Evropiane për Drejtësi ka gjetur vitin e kaluar se Franca nuk është duke respektuar nivelet e dyoksidit të azotit, andaj muajin e kaluar Komisioni Evropian ka dërguar Parisin në gjyq për ndotje të ajrit. Polonia, po ashtu, është dërguar në gjyq më 2018, për tejkalim të niveleve të ndotjes së ajrit.

Numër rekord i stuhive në Atlantik

NJU-JORK, 10 NËNTOR - Sezoni i uraganeve këtë vit në Atlantik ka thyer rekord sa i përket numrit të stuhive, ka njoftuar Qendra Kombëtare për Uragane në Shtetet e Bashkuara. Stuhia subtropikale, Teta, është e stuhia e 29 me radhë në Atlantik këtë vit, duke thyer rekordin e vitit 2005, kur ishin regjistruar 28. Disa shkencëtarë kanë thënë se ndryshimet klimatike kanë ndikuar në rritjen e intensitetit të stuhive. Stuhitë, kryesisht të rrezikshme, marrin emrat ashtu që të vetëdijesohet publiku para goditjes. Sezoni i stuhive, që nis në qershor e vazhdon deri në nëntor, ka prodhuar disa stuhi të

fuqishme, duke përfshirë Etan, që ka goditur Floridan gjatë fundjavës. Zeta ka goditur Luizianën në fund të tetorit, duke u bërë e pesta me radhë që prek këtë shtet në këtë sezon. Teta, që nuk është saktësisht stuhia, është duke u bartur drejt jugut të Evropës. Kjo sezon është, po ashtu, e para nga viti 2005, kur 21 emrat alfabetikë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë janë përdorur për shkak të numrit të madh të stuhive. Pjesa tjetër më pas është emërtuar me emra grekë. Shkencëtarët thonë se stuhitë janë bërë më të fuqishme teksa temperatura e oqeanëve rritet, duke ofruar më shumë energji për stuhi.



Vdes kryenegociatori i palestinezëve në bisedimet e paqes me Izraelin

RAMALLAH, 10 NËNTOR - Një nga figurat më të shquara të politikës palestineze, Saeb Erekat, ka vdekur pasi është infektuar me koronavirus, konfirmuan të martën zyrtarët e këtij shteti. Erekat, 65 vjeç, ka vdekur në Jerusalem, në Qendrën Mjekësore Hadassah, ku është shtruar

muajin e kaluar. Ai ka qenë me vite kryenegociatori i palestinezëve në bisedimet për paqe me Izraelin. Duke e përshkruar si "vëlla" dhe "luftëtar", presidenti palestinez, Mahmoud Abbas,



shpalli tri ditë zie për Erekatin. Erekat, po ashtu, ka qenë sekretar i përgjithshëm i lëvizjes kryesore palestineze të njohur si Organizata Çlirimtare e Palestinës, si dhe këshilltar i Abbasit. Ai ka marrë

pjesë në negociimin e Marrëveshjeve të Oslos më 1993, me të cilat është krijuar Autoriteti Palestinez dhe palestinezëve u është dhënë vetëqeverisja e kufizuar në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës, për herë të parë prej Izraeli i ka pushuar territoret më 1967.

Në Kosovë edhe pesë viktima dhe 596 raste të reja me Covid-19

Pesë viktima dhe 596 raste të reja me Covid-19 u konfirmuan të martën në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se rastet e reja rezultojnë nga testimi i 1 559 mostrave, ndërsa viktimat janë regjistruar: dy në Gjilan, dy në Prizren dhe një në Suharekë. Komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të rasteve të reja pozitive: 295. IKShPK-ja ka njoftuar se në 24-orëshin paraprak, 136 pacientë janë shëruar nga ky virus

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 559 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve

rezultojnë 596 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të personave të vdekur me Covid. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan dy raste (72 dhe 50 vjeç), Prizren dy raste (70 dhe 67 vjeç) dhe Suharekë një rast (58 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 25 388 raste nga 110 041 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 773 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 136 pacientë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 16 362 raste, kurse numri i rasteve aktive është 8 253. Rastet pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 295 raste, komuna Gjilan 51 raste, Komuna Gjakovë 39 raste, Komuna Fushë-Kosovë 38 raste, Komuna Prizren 26 raste, Komuna Lipjan 17 raste, Komuna Viti 14 raste, Komuna Deçan 13 raste, Komuna Drenas 13 raste, Komuna Kamenicë 13 raste, Komuna Pejë 11 raste, Komuna

Rahovec 10 raste, Komuna Suharekë 8 raste, Komuna Klinë 6 raste, Komuna Podujevë 6 raste, Komuna Kaçanik 5 raste, Komuna Malishevë 5 raste, Komuna Vushtrri 5 raste, komuna Ferizaj 4 raste, Komuna Mitrovicë 4 raste, Komuna Obiliq 4 raste, Komuna Istog 2 raste, Komuna Junik 2 raste, Komuna Shtime 2 raste dhe me nga një rast Komunat Hani i Elezit, Novobërdë dhe Skenderaj. Të martën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i shoqëruar edhe nga drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka takuar ushtruesen e presidentes, Vjosa Osmani. Në takim është diskutua për gjendjen aktuale në sferën e menaxhimit të pandemisë

Covid-19 si dhe për mundësitë e koordinimit institucional. Osmani ka thënë se është i domosdoshëm koordinimi me Ministrinë e Shëndetësisë në kohën e emergjencës shëndetësore, duke rritur kujdesin dhe respektuar maksimalisht masat mbrojtëse ndaj Covid-19. Ajo ka shfaqur gatishmërinë për ta mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë në nismat e saj që kanë për synim përballimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia. Ndërkaq ministri Zemaj e ka njoftuar Osmanin për masat anti-Covid, duke paralajmëruar kategorizimin e komunave sipas numrit të banorëve të infektuar. Ai ka thënë se vendimet e MSH-së do të jenë në përputhje me situatën në terren.



Osmani: Hoti më ka konfirmuar se nuk ka planifikuar takime rreth dialogut

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po ushtron edhe detyrën e presidentes së vendit, ka thënë se nuk është planifikuar ndonjë takim me palën serbe sa i përket dialogut. Osmani në konferencë ka bërë me dije se vetë kryeministri Avdullah Hoti gjatë takimit që kishte me të, i kishte konfirmuar se nuk ka planifikuar ndonjë takim me palën serbe. "Nuk e kam fjalën për një shtyrje, por nëse vendoset që të vazhdohet këto ditë, nuk më duket se Kosova do të jetë në kushte të favorshme për të vazhduar tani me këto takime. E kam



diskutuar edhe dhe i kam thënë se nuk mendoj se është e favorshme kjo kohë për të vazhduar dialogu, ndërsa ai më konfirmoi se nuk ka të

planifikuar ndonjë takim gjatë ditëve të ardhshme", ka deklaruar Osmani. Sa i përket pjesëmarrjes së saj në këtë proces, ajo ka thënë se

nuk është ftuar që të marrë pjesë në procesin e dialogut. Osmani u shpreh se nuk është e domosdoshme prania e të gjithëve në dialog, por duhet të jenë të gjitha forcat politike të bashkuara në një qëndrim që do të përfaqësojë në këtë dialog nga përfaqësuesi legjitim. "Nuk besoj se do të ishte racionale, që të futem në një proces në të cilin nuk kam marrë pjesë nga fillimi, apo të marrë përsipër marrëveshje që i kanë negociuar të tjerët. Është tjetër gjë kur ulem nga fillimi dhe marr përsipër negociatat, por të marr përsipër marrëveshje të cilat i kanë negociuar të tjerët, nuk

mendoj se është racionale dhe nuk i ndihmon situatën. Do të bëj të pamundurën ta ndihmoj shtetin tim. Nuk është që kam pasur kërkesë nga dikush në Kosovë që ta jap kontributin tim. Përtej rolit tim personal mendoj se të gjitha forcat politike të jenë të bashkuara. Është mirë që Kosova të jetë sa më mirë e përfaqësuar. Kjo nuk do të thotë që duhet prania e secilit në Bruksel, por nënkupton se në Kosovë duhet ta ndërtojmë një qëndrim dhe që ai qëndrim të përfaqësohet nga përfaqësues legjitimë të Kosovës", ka thënë Osmani në një konferencë për media.

KADRI VESELI ËSHTË PARAQITUR PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

VESELI DEKLAROHET I PAFAJSHËM PËR TË GJITHA PIKAT E AKTAKUZËS



Ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, Kadri Veseli, është deklaruar i pafajshëm për akuzat e Dhomave të Specializuara në Hagë. Në paraqitjen e parë para kësaj gjykate, ai ka thënë se me bindje të plotë mohon të gjitha pikat e aktakuzës së ngritur ndaj tij. “I nderuar gjykatës, i dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të deklarohe me bindje të plotë, se jam i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës”, ka deklaruar Veseli. Avokati i Veselit, Ben Emmerson, i cili në këtë seancë është lidhur përmes videovjegëzës, ka reagu ndaj procesverbaleve të gjykatës në të cilat thuhet se ai është arrestuar. Avokati ka treguar se Veseli është paraqitur në Hagë vullnetarisht, duke shtuar se do ta kërkojë lirin e tij të parakohshëm

Mbrojtja: Veseli u dorëzua vullnetarisht në Hagë

Avokati i Veselit, Ben Emmerson, i cili në këtë seancë është lidhur përmes videovjegëzës, ka reagu ndaj procesverbaleve të gjykatës, në të cilat thuhet se ish-kreu i PDK-së është arrestuar. Ai ka treguar se Veseli është paraqitur në Hagë vullnetarisht, në bazë të një marrëveshjeje me prokurorin, duke shtuar se do ta kërkojë lirin e tij derisa procesi të fillojë. “Z. Veseli duhet të presupozohet i pafajshëm për të gjitha akuzat. Duke vijuar nga kjo, gjykata do të marrë parashtrim ose kërkesë që Veseli të lirohet deri në pritje të fillimit të gjykimit. Desha të shënohet në proces verbal fakti se z.Veseli është arrestuar, ju si gjykatës duhet të dini se Veseli erdhi në gjykatë në bazë të një marrëveshjeje paraprake, vullnetarisht. Dorëzimi i tij vullnetar u bë me kërkesë të avokatit. Është e drejtë ta theksoj se ditën që u dorëzua ai ka dorëzuar deklaratë të cilën dua ta

lexoj”, ka thënë Emmerson. Më pas, avokati Emmerson ka lexuar edhe një mesazh të Veselit për Gjykatën Speciale. “Pres që gjykatësit do të japin vendim të drejtë në fund. Kjo gjykatë është pjesë e ligjit tonë, nuk duhet të kemi mëri ndaj gjykatësve që punojnë në këtë Tribunal. Tribunali është pjesë e krijimit të Kosovës, do ta çojmë këtë kërkesë deri në fund”, ka deklaruar avokati.

Gjatë kësaj paraqitjeje të parë të Veselit para gjykatës në Hagë, gjykatësi i procedurës paraprake, po ashtu, është konsultuar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe palën mbrojtëse lidhur me datën për mbajtjen e konferencën statuto. Si datë për këtë konferencë është propozuar 18 nëntori. Në Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në rregullën 96 thuhet: “Gjykatësi i procedurës paraprake thirr një konferencë mbi ecurinë e çështjes sa më shpejt që të jetë e mundshme, pas paraqitjes së parë të të akuzuarit”.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ish-kreu i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Kadri Veseli, po bën paraqitjen e parë para Dhomave të Specializuara në Hagë. Ndaj tij rëndojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai u deklarua i pafajshëm ndaj këtyre akuzave. “I nderuar gjykatës, i dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të

deklarohe me bindje të plotë, se jam i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës”, ka deklaruar Veseli kur është pyetur nëse dëshiron të deklarohe i pafajshëm apo fajtor për aktakuzën.

Veseli, që gjatë luftës ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është arrestuar më 5 nëntor dhe është dërguar në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ai dyshohet për vepra penale që kanë të bëjë me krime lufte, ndalim të

paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999. Sekretarja e Gjykatës, pasi lexoi dhjetë pikat e aktakuzës, tha se ekziston dyshimi i bazuar se Veseli është penalisht përgjegjës për këto krime.

Hoxhaj: Kadriu sërish do të dalë fitimtar

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, ka reaguar pas seancës së parë gjyqësore të Kadri Veselit në Gjykatën Speciale. "Miku im Kadri Veseli sot u ngrit për ta mbrojtur të vërtetën e pandryshueshme të luftës legjitime të popullit tonë për liri dhe pavarësi. Kadriu është mishërimi i vlerave më të larta njerëzore dhe atdhetare. Misioni i tij para, gjatë luftës dhe pas saj është i jashtëzakonshëm, përherë në shërbim të çështjes kombëtare, në veçanti të Kosovës së pavarur. Roli i tij

në luftë dhe në paqe e ka bërë Ballkanin një rajon më të drejtë e të sigurt", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se ai sërish do të dalë fitimtar. "Durimi i tij i pakufishëm dhe karakteri i pathyeshëm janë vetitë me të cilat ai do t'i rrënojë muret e paragjyqimeve, muret e akuzave të pabaza, muret e shpifjeve që të tjerët i kanë ndërtuar tash e disa dekada. Kadriu sërish do të dalë fitimtar në këtë betejë të radhës së luftës së tij të gjatë për liri dhe pavarësi të Kosovës", ka deklaruar Veseli.

Veseli, që gjatë luftës ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u arrestua më 5 nëntor dhe u dërgua në qendrën e paraburgimit në Hagë. Një ditë më parë edhe ish-drejtori politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, kanë hedhur poshtë pretendimet e Dhomave të Specializuara për krime lufte ndaj tyre. Në paraqitjen e parë para këtyre dhomave në Hagë, Thaçi dhe Krasniqi kanë thënë se akuzat ndaj tyre janë të pabaza. "Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës", ka deklaruar Thaçi kur është pyetur nga gjykatësi i procedurës paraprake nëse ndihet i pafajshëm apo fajtor rreth aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai ka deklaruar se aktakuzat kundër tij janë të paqëndrueshme. Njëjtë ka deklaruar edhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, i cili është paraqitur në seancë paraditen e së hënës. "Unë nuk ndihem fajtor e as përgjegjës për asnjë pikë që thuhet në aktakuzë dhe për asnjë gjë tjetër që thuhet në aktakuzë", ka deklaruar Krasniqi gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuara, kur është pyetur nëse deklarohet

i pafajshëm apo fajtor për krimet që rëndojnë ndaj tij. Krasniqi, para se të deklarohet për aktakuzën, ka mbajtur një fjalim para gjykatës, ku ka deklaruar se është bërë një padrejtësi e madhe ndaj tij. "Cilësimi i prokurorit të Dhomave të Specializuara, se ne qenkemi ndërmarrje kriminale e përbashkët, për mua, shokët e mi, familjen time që luftuam gjatë, por edhe për kombin tonë, nuk ka diçka më fyese, pasi ne një kohë të gjatë, në rrethana tepër të vështira jetë a vdekje, u vumë në shërbim të lirisë e të shtetndërtimit të cilat i arritëm në bashkëveprim me Shtetet e Bashkuara, me vendet e Bashkimit Evropian, me NATO-n, me OKB-në dhe të gjithë së bashku ishim dhe jemi ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe shtetformuese", ka deklaruar Krasniqi gjatë një fjalimi para Gjykatës në Hagë. Edhe pala mbrojtëse e Thaçit dhe Krasniqit ka paralajmëruar se në javët në vijim do ta dorëzojnë kërkesën për lirim dhe për kohshëm të tyre. Ndërsa sot (e mërkurë) para Dhomave të Specializuara do të dalë edhe ish-epropri i lartë i UÇK-së dhe ish-deputeti i LV-së, Rexhep Selimi.

Deputetja Musliu: T'i ulim shpatat partiake dhe politike dhe t'i ngrehim ato kombëtare dhe atdhetare



Sot është e nevojshme më shumë se kurrë që t'i ulim shpatat partiake dhe politike dhe t'i ngrehim ato kombëtare dhe atdhetare", ka deklaruar Ganimete Musliu

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Në mbledhjen e së martës të Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pika të rendit të ditës ishin diskutimi rreth raportit të Ministrisë së Mbrojtjes rreth zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2019, si dhe të gjeturat e raportit për vendin të Komisionit Evropian për vitin 2020 në fushën e sigurisë, mirëpo ky takim është shtyrë për një ditë tjetër, në shenjë solidarizimi me ish-pjesëtarët e UÇK-së, ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzë nga Gjykata Speciale në Hagë.

Fillimisht, kryetarja e komisionit, Fatmire Kollçaku, ka thënë se në këtë mbledhje nuk është anëtar i Komisionit, Rexhep Selimi, i cili, edhe të tjerët me të, po përballen me një gjykatë të padrejtë në Hagë. "Të gjithë e dimë se lufta çlirimtare e popullit të Kosovës, në krye me UÇK-në, ka qenë e drejtë dhe ne jemi të bindur se kjo do të dëshmohet atje dhe do të kthehen sa më shpejt në Kosovë", ka thënë Kollçaku. Anëtarja e komisionit, Ganimete Musliu, gjatë diskutimit të saj ka thënë se sot është një moment jo i

lehtë si shtet dhe si përfaqësues të popullit. "Sot është e nevojshme më shumë se kurrë që t'i ulim shpatat partiake dhe politike dhe t'i ngrehim ato kombëtare dhe atdhetare", ka deklaruar Musliu, e cila me këtë rast ka propozuar që kjo mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër, në shenjë solidarizimi me anëtarin e këtij komisioni, Rexhep Selimi dhe të gjithë ish-ushtarët çlirimtarë të Kosovës. Ky propozim në mënyrë unanime u përkrah nga Komisioni, ndërkaq kjo mbledhje do të mbahet një ditë tjetër.

Mbretëria e Bashkuar, ndër mbështetëset kryesore në procesin e tranzicionit të FSK-së

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të martën në takim këshilltarin e Transformimit të Mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor, gjeneralbrigade Johnny Bowron. Në takim, ministri Quni e ka njoftuar brigadierin Bowron për zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK, për të arriturat gjatë procesit aktual të

tranzicionit dhe për sfidat e shfaqura gjatë krizës aktuale të pandemisë Covid-19. Ai, ndër të tjera, ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për rolin dhe kontributin e madh të shtetit, të qeverisë dhe të Forcave të Armatosura Britanike për ndërtimin dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit tonë, vetë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Sigurisë së Kosovës.

Në takimin e radhës me brigadierin Bowron, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rahman Rama, ka theksuar se partneriteti me Forcat e Armatosura Britanike do të vazhdojë të jetë i fuqishëm në perspektivën tonë zhvillimore për t'i arritur aftësitë, kapacitetet dhe standardet më të larta operacionale. Nga ana e tij, brigadierin Bowron



ka shprehur vlerësimin e lartë për strategjinë e tranzicionit të MM/FSK-së si dhe të arriturat e deritashme duke shprehur mbështetjen nga autoriteti zyrtar dhe përvoja e tij për këtë proces edhe në të ardhmen. Ministri

Quni gjatë takimit shoqërohej nga këshilltari i tij ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha.

Asociacioni i komunave përfiton edhe një projekt nga NALAS-i

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka nënshkruar edhe një projekt tjetër me RCDN (Rrjetin Regional për Ngritje të Kapaciteteve) i cili zbatohet nga NALAS (Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore). Marrëveshja për projektin është nënshkruar nga drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahimimi dhe drejtori ekzekutiv i NALAS-it me seli në Shkup, Kelmend Zajazi.

Qëllimi i Projektit "Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve" është që t'i përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin në ndërmarrjet për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit në Ballkanin Perëndimor. Pastaj, për ofrimin më të mirë të shërbimeve për një numër më të madh të popullatës me qasje në ujë të pijshëm dhe kanalizim, me qëllim të përmbushjes së

kërkesave të parapara nga Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian për mjedisin.

AKK-ja si pjesë e rrjetit NALAS do të vazhdojë ta zbatojë këtë projekt, i cili do t'i mbulojë fushat që do të ndihmojnë në organizimin më eficient dhe menaxhim më efektiv të furnizimit me ujë dhe shërbime të kanalizimit, përmes zhvillimit të një platforme të bashkëpunimit siç është paraparë me legjislacion në mes të komunave dhe kompanive rajonale të ujit. Në këtë platformë do të parashihen edhe të gjitha modalitete praktike të bashkëpunimit, si koordinimi i investimeve në furnizim me ujë, infrastrukturën e kërkuar për trajtim të ujërave të zeza me planet zhvillimore komunale, bashkëpunimi në raste emergjence, kycja e

konsumatorëve në rrjet, sistemi i ujërave të zeza etj.

Po ashtu, parashihet të bëhen shkëmbime të përvojave në nivel rajonal në fushën e ujërave dhe kanalizimit, trajtimi i ujërave të zeza në të ardhmen dhe një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfaqësimit të nivelit lokal në Kosovë në komisionet këshilluese të konsumatorëve. Vlen të ceket se rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve (RCDN) punon me 16 asociacione të pushtetit lokal dhe asociacionet e ndërmarrjeve të ujit në gjashtë shtete (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi), derisa përfitues janë menaxherët e nivelit të lartë dhe të mesëm nga kompanitë si dhe zyrtarët përgjegjës në komuna. Zbatimi i këtij projekti të nënshkruar sot do të bëhet deri në shkurt të vitit 2021.



RrGK-ja kërkon integrimin e perspektivës gjinore në tekstet e reja shkollore

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) përmes një reagimi ka shprehur shqetësim për faktin se tekstet shkollore që mirëmbajnë pabarazitë gjinore ende vazhdojnë të jenë në përdorim nga nxënësit. "Në librin e klasës së pestë 'Njeriu dhe natyra' autorët pyesin nxënësit: 'Pse femrat që zbulojnë belin rrezikojnë të mbeten sterile?' Ky tekst, për të cilin ka raportime në media tash e tri vjet, duhet të rishikohet dhe ndërrohet urgjentisht. Ky nuk është rast i izoluar, por kur në tekstet shkollore hasim fjali si 'Nëna kryen punët e shtëpisë', nuk janë thjesht një lëshim. Madje nëse nuk veprohet menjëherë, një sistem edukativ arsimor si ky vetëm se rritë pabarazitë dhe diskriminimin gjinor, i cili veçse është mjaft shqetësues dhe një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlemi sot si shoqëri, organizata dhe institucione",



theksohet në reagimin e RrGK-së.

Për më tepër, RrGK-ja ka kujtuar se Kuvendi i Kosovës në shtator të këtij viti ka miratuar futjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës. "Neni 14 i kësaj konvente, i cili flet për

arsimin, përcakton se palët marrin hapat e nevojshëm për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje si barazia mes burrave dhe grave, mosstereotipizim i roleve gjinore, respekti i ndërsjellë dhe zgjidhja e konflikteve pa dhunë.

Kjo konventë parasheh themelimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat për ngritjen e vetëdijes të nxënësit, prindërit dhe mësimmësuesit në lidhje me këtë temë. Përmirësimi i kurrikulës dhe

teksteve shkollore nga perspektiva gjinore është pjesë e programit të RrGK-së "Përmirësimi i qasjes në edukim të ndjeshëm gjinor", si një nga parakushtet për të jetuar në një shoqëri ku gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë gëzojnë një jetë të barabartë, me mundësi të barabarta në arsim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë", është thënë në reagimin e RrGK-së.

Duke kujtuar se barazia gjinore është jetike për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, respektimin e ligjit dhe demokracisë, RrGK-ja kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës që në konkursin e hapur së fundi për tekste shkollore të reja dhe materiale për të gjitha klasat, t'i përmirësojë tekstet si ky i lartcekuri dhe të sigurohet për integrimin e perspektivës gjinore.

Von Cramon: Shpresojmë ta shohim dritën në fund të tunelit për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon, ka vizituar Ambasadën e Kosovës në Gjermani. Von Cramon është një zë i fuqishëm i qytetarëve të Kosovës dhe një avokuese e të drejtave të tyre në Evropë", ka shkruar ai.

Më pas, Von Cramon ka rishpërndarë postimin e Cufajt, duke thënë se shpreson që më në fund të shihet drita në fund të

tunelit sa i përket liberalizimit të vizave. "Kënaqësia ishte e imja. Faleminderit shumë për mikpritjen në Ambasadën e Kosovës në Gjermani dhe për shkëmbimin e thellë për zhvillimet politike në Kosovë. Shpresojmë që ne mund ta shohim dritën në fund të tunelit së shpejti për liberalizimin e vizave për Kosovën", ka shkruar Von Cramon.



VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR PAJTOHEN PËR TREG TË PËRBASHKËT DHE PËR POLITIKA TË GJELBRA

Hoti: Mosnjohja nga Serbia dhe Bosnja, pengesë për bashkëpunim ekonomik rajonal



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në takim virtual të Samitit të Sofjes, ka thënë se pengesë për zhvillim të plotë të potencialit të bashkëpunimit ekonomik rajonal është mungesa e normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis vendeve të rajonit, veçanërisht mungesa e njohjes së Kosovës nga Serbia dhe nga Bosnja e Hercegovina

thënë Hoti. Ai ka theksuar se ajo që na pengon neve për zhvillim të plotë të potencialit të bashkëpunimit ekonomik rajonal është mungesa e normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis vendeve të rajonit, veçanërisht mungesa e njohjes së Kosovës nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. “Unë pres që procesi i dialogut në Bruksel do të përfundojë me sukses së shpejti. Ne jemi të përkushtuar që t’i zgjidhim të gjitha çështjet bilaterale me Serbinë si pjesë e procesit të Brukselit. Duhet theksuar se jo të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, janë në të njëjtën shkallë të integriteteve evropiane. Për më tepër, disa vende të rajonit kanë marrëveshje të tregut të lirë me vendet e treta të Lindjes dhe Lindjes së Largët, që u mundësojnë atyre qasje në tregjet tona pa kontribut të domosdoshëm në infrastrukturën sociale dhe fizike të rajonit”, është shprehur kryeministri Hoti, i cili ka bërë thirrje për një pajtim rreth krijimit të një mekanizmi i cili siguron një proces të koordinuar të vendimmarrjes të çdo vendi të rajonit tonë për çështje që kanë të bëjnë me tregun e përbashkët rajonal. “Në fund, më lejoni të theksoj se Zona Ekonomike Rajonale në asnjë mënyrë nuk është alternativë për integrimin

evropian. Kjo duhet të na ndihmojë për ndërtimin e kapaciteteve të domosdoshme, për përshtetjen të anëtarësimit të plotë dhe të përbashkët të vendeve tona në Bashkimin Evropian. Pikërisht për këtë, e mirëpres dhe e mbështes këtë proces. Kosova do t’i ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për ngritje të kapaciteteve, gjithnjë në baza të barabarta”, ka deklaruar kryeministri Hoti. Pas samitit, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, në konferencën e përbashkët për media me homologun bullgar Bojko Borisov dhe kancelaren gjermane Angela Merkel, ka thënë se nënshkrimi i deklaratës së përbashkët e afron rajonin me BE-në. “Kjo do të ndikojë në rritje ekonomike dhe zhvillim të rajonit. Rajoni e ka kuptuar rëndësinë e lidhjes biznesore, lëvizjes së rinisë, lidhjes digjitale, dialogut ndërmjet shoqërisë civile se si të shkëmbejmë informacione, në mënyrë që të garojmë në tregjet globale”, ka deklaruar Zaev. Kancelarja gjermane Angela Merkel, që mori pjesë në konferencën për media në mënyrë virtuale, i përgëzoi liderët e Ballkanit Perëndimor për ndërmarrjen e këtyre zotimeve pasi, sipas saj, procesi i Berlinit ka qëllim tejkalimin e tensioneve dhe trashëgimisë së të kaluarës. “Është me rëndësi pajtimi për

krijimin e një tregu të përbashkët, veçmas në këto kohë të vështira, duke marrë parasysh se shumë vende janë nën presion. Ky është mesazh inkurajues edhe për ekonomitë tona dhe kjo do t’i japë rezultatet e veta”, vlerësoi Merkel. Ajo shprehu kënaqësinë që përmes projekteve të realizuara deri më tash, mijëra të rinj nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pasur mundësi të shkëmbimit të përvojave dhe takimeve të drejtpërdrejta. Kryeministri bullgar Bojko Borisov përmendi faktin se BE-ja tashmë ka premtuar investime prej 9 miliardë dollarësh dhe ka thënë se tregu i përbashkët rajonal do ta rrisë mirëqenien e qytetarëve. “Kjo ka qenë ideja jonë, ëndrra jonë. Është një popullatë prej 20 milionë banorësh në Ballkanin Perëndimor, prandaj duam që ata njerëz të kenë të ardhura më të mëdha. Duam, po ashtu, që këta njerëz të jetojnë në vendet e tyre”, ka thënë Borisov. Procesi i Berlinit, një iniciativë diplomatike e kancelares gjermane Angela Merkel, filloi në vitin 2014, me qëllim për të mbështetur një të ardhme paqësore, të qëndrueshme dhe demokratike të Ballkanit Perëndimor, si dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian të rajonit.


EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka marrë pjesë në Samitin e Sofjes - Vendet e Ballkanit Perëndimor 6, i cili është vazhdimësi e Procesit të Berlinit. Tema e Samitit të Sofjes ishte Tregu i Përbashkët Rajonal - Katalizator drejt Tregut të Bashkimit Evropian. Në fund të këtij samiti gjashtë vendet anëtare të Ballkanit Perëndimor nënshkruan dy deklaratat, atë për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Deklaratën për Agjendën e Gjellbër. Për shkak të pandemisë me Covid 19 takimi ishte virtual. Në këtë takim, përpos përfaqësuesve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, morën pjesë edhe kancelarja gjermane Angela Merkel, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe burrështetas të

tjerë të vendeve anëtare të BE-së. Me këtë rast, kryeministri Hoti ka thënë se janë duke ndërmarrë një hap të rëndësishëm së bashku si gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, të barabartë në të drejta dhe përgjegjësi. “Besoj se sot jemi duke ndërmarrë një hap të rëndësishëm së bashku si gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, të barabartë në të drejta dhe përgjegjësi. Është e qartë se bashkëpunimi ekonomik rajonal stimulon rritjen, shton konkurrencën dhe investimet e huaja në rajon, duke shpejtuar konvergencën tonë në drejtëm të Bashkimit Evropian. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, edhe tani janë zonë e tregtisë së lirë, por për t’i realizuar përfitimet e plota të bashkëpunimit tonë rajonal, ne duhet t’i largojmë të gjitha barrierat e lëvizjes së lirë të mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe të njerëzve. Kosova është e përkushtuar që ta arrijë këtë”, ka

Ministri Abrashi vizitoi aeroportin për ta parë nga afër zbatimin e masave anti-Covid

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, i shoqëruar edhe nga drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, Bujar Ejupi, kanë vizituar të martën Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, ku kanë parë zbatimin e masave anti-Covid



Zbatimi i masave nga protokollin e shëndetit në aviacion gjatë kontrollit fizik të udhëtarëve.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të vazhdojë mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre masave të cilat

bazohen në planin e veprimit të operatorit dhe protokollit të shëndetit në aviacion.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, Bujar Ejupi, kanë vizituar të martën Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” dhe kanë mbikëqyrur masat e ndërmarra nga operatori i aeroportit LIMAK, me qëllim të frenimit të përhapjes së Covid-19.

Ministri Abrashi ka thënë se në këtë kohë pandemie masat e ndërmarra për t'u mbrojtur nga Covid-19 janë esenciale për funksionimin e aeroportit. “Në bazë të raporteve të inspektorëve të AAC-së gjatë

zhvillimit të mbikëqyrjes së rregullt të masave të ndërmarra nga operatori në periudhën qershor-tetor dhe situatës së konstatuar gjatë vizitës, ka një shkallë të kënaqshme të zbatimit të masave për frenimin e përhapjes së Covid-19, të parashikuara sipas Urdhresës Administrative të aprovuar nga AAC”, ka deklaruar ministri Abrashi.

Gjatë vizitës zyrtarët e Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” shpalosën masat e ndërmarra siç janë: Aktivizimi i tunelit automatik dezinfektues në hyrje të terminalit për çdo udhëtar; Mbikëqyrja e temperaturës trupore për çdo udhëtar në nisje përmes kamerës termike;

Shënohet Dita Botërore e Planifikimit të Qyteteve

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Me rastin e Ditës Botërore të Planifikimit të Qyteteve, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit është shënuar kjo ngjarje me anë të një tryeze të përbashkët me përkrahës të këtij sektori dhe është bërë shpallja e fituesve të një gare me fotografi.

Ministri Blerim Kuçi, gjatë kësaj ngjarje, përveç tryezës së diskutimit me Shkëlqim Dacin nga GIZ dhe Arjeta Himadunën nga UN Habitat, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me UN Habitat, që është një vazhdimësi e ndihmës për ministrinë në fushën e planifikimit.

Rëndësia e planifikimit urban u potencua nga ministri Kuçi, duke mos i përjashtuar problemet që janë në këtë fushë. “Duke shënuar këtë ngjarje të rëndësishme, po dëshmojmë se edhe Kosova është duke e përcjellë trendin global të planifikimit hapësor dhe se jemi në rrugë të mirë për të krijuar një platformë të mirëfilltë të diskutimit, në bazë të së cilës do t'i planifikojmë politikën, qëllimet, objektivat dhe veprimet e ardhshme në këtë fushë”, ka thënë Kuçi.

Në këtë diskutim u treguan arritjet e ministrisë në fushën e planifikimit, sikur janë: Harta Zonale e Kosovës, që është përfunduar si dokument dhe



është në procedurë të opinionëve dhe pëlqimeve nga institucionet e tjera qeveritare, Plani Hapësor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemura” i cili, gjithashtu, është përfunduar dhe po pret përgjigjet e njëjta nga

institucionet qeveritare dhe ka filluar iniciativa për Revidim ose Hartim të Planit të ri Hapësor për Parkun Kombëtar “Sharri”. Në anën tjetër, MEA ka miratuar nëntë plane zhvillimore lomonale dhe katër harta zonale komunale. Si pjesë e

organizimit të kësaj ngjarje, në hollin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit u hap edhe ekspozita nga konkursi i fotografisë “Qyteti im gjatë pandemisë”, ku ministri Blerim Kuçi, bashkë me zëvendësministre Burbuqe

Deva-Bakija dhe drejtorin e Institutit për Planifikim Hapësor, Luan Nushi, ndan shpërblimet për fituesit: Vendi i parë për Kushtrim Krasniqin, vendi i dytë për Arben Llapashicën dhe vendi i tretë për Astrit Malokun.

Rukiqi: Mbi një miliard euro rënia e qarkullimit në ekonominë e Kosovës



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka bërë me dije se çdo mbyllje e re për shkak të pandemisë Covid-19 në Kosovë, pa përkrahje financiare nga shteti, rrezikon edhe humbjen e mijëra vendeve të punës

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Rikthimi i karantinës në fundjavë ka nxitur reagimin e shumë bizneseve të cilat u detyruan të mos ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Një mbyllje si kjo dhe çdo kufizim shtesë e pa përkrahje nga Qeveria e Kosovës po shihet edhe si shkuarje drejt një kolapsi ekonomik. Kështu ka thënë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, duke shtuar se çdo mbyllje e re, pa përkrahje financiare nga shteti, rrezikon edhe humbjen e mijëra vendeve të punës.

Derisa flet për problemet që mund të krijohen nga rikthimi i karantinës, Rukiqi për "KosovaPress" ka treguar edhe se shkak i pandemisë Covid-19 ekonomia e Kosovës tashmë ka pësuar rënie mbi një miliard euro krahasuar me vitin që lamë pas. "Çdo mbyllje e re dhe çdo mos përkrahje financiare, nëse ka mbyllje të re, e rrezikon shumë ekonominë e vendit, rrezikon mijëra vende pune, po ashtu edhe nëse nuk merren masa adekuate për rimëkëmbjen ekonomike. Po ashtu, kjo për shumë sektorë do të jetë fatale", ka thënë Rukiqi.

Ai ka theksuar se për shkak të pandemisë Covid-19 u shuan edhe shumë vende të punës. "Ne kemi mbi një miliard euro rënie të qarkullimit në ekonominë tonë në krahasim me vitin e kaluar. Shohim se kemi efekte edhe në buxhetin e vendit për shkak se dogana nuk ka arritur ta përmbushë planin të cilin e ka pasur. Nëse e

krahason me vitin e kaluar, njëjtë është edhe te mbledhja e tatimeve, po ashtu kemi shumë vende pune të cilat veç kanë filluar të shuhen për shkak se ka rënë kërkesa në përgjithësi dhe të gjitha këto e bëjnë situatën më të vështirë tani në këtë dimër, krahas edhe panikut dhe sigurisë sa i përket menaxhimit të pandemisë", ka thënë ai.

Situata ekonomike e krijuar nga pandemia Covid-19 u bë edhe arsye e takimit të së martës me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti dhe drejtorin të Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës (OEAK), Arian Zeka dhe kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi.

Rukiqi ka thënë se në këtë takim kanë ndarë shqetësimin rreth çdo mbylljeje dhe kufizimi shtesë i cili rrezikon sistemin financiar në vend. Mes të tjerash, ai thotë se situata ekonomike në vend asnjëherë s'ka qenë e lakmueshme, por që pandemia tani ka krijuar pasoja afatgjata në shumë sektorë. "Ndamë shqetësimin e përbashkët që çdo mbyllje e re, apo kufizim shtesë, e rrezikon edhe sistemin financiar. Dhe kur rrezikohet sistemi financiar, atëherë ai kolaps i shtetit është shumë afër. Situata nuk është e lehtë. Domethënë ne kurrë nuk kemi pasur situatë ekonomike të lakmueshme, ndërsa pandemia këtë vit veç ka lënë pasoja afatgjata në shumë sektorë", ka thënë Rukiqi.

Guvernatori i BQK-së dhe drejtuesit e odave ekonomike diskutojnë për parametrat ekonomikë dhe financiarë

PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi dhe drejtorin ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, në kuadër të takimeve të rregullta që drejtuesit e tri organizatave kanë pasur prej shpërthimit të pandemisë Covid-19.

Gjatë takimit u diskutua për parametrat aktualë ekonomikë dhe financiarë, ndërsa u theksua shqetësimi i përbashkët që aplikimi i masave të reja për kufizimin e aktiviteteve ekonomike do të kishte në operacionet e ndërmarrjeve, por edhe në kërcënimet për

stabilitetin e sektorit financiar.

Duke e konsideruar me prioritet ruajtjen e shëndetit publik, guvernatori Mehmeti si dhe drejtuesit e të dyja odave ekonomike, Rukiqi e Zeka, nënvizuan edhe rëndësinë e ruajtjes së shëndetit të ndërmarrjeve private, të cilat bartin barrën e punësimit dhe rritjes ekonomike në vend.

Që të tre bashkëfolësit shprehën besimin se duhet të gjendet balanca ndërmjet lejimit të operimit të papenguar të ndërmarrjeve, por edhe mbikëqyrjes më të rreptë të zbatimit të masave që synojnë parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19, tashmë kur në tërë vendin ka përkeqësim të situatës epidemiologjike.



Shtabi Emergjent i Podujevës kërkon zbatim të masave anti-Covid

PODUJEVË, 10 NËNTOR (ER) - Shtabi Emergjent i Komunës së Podujevës për veprime dhe masa parandaluese e mbrojtëse nga Covid-19 në takimin e mbajtur të martën ka diskutuar rreth gjendjes së rënduar javët e fundit me pandeminë, masat dhe vendimet e qeverisë gjatë fundjavës së kaluar dhe masat që mund të merren së shpejti nga Qeveria e Kosovës.

Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka informuar anëtarët e shtabit emergjent lidhur me gjendjen e rënduar epidemiologjike në komunë dhe ka informuar rreth takimit virtual të mbajtur

të hënën me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe drejtorin e IKShPK-së, Naser Ramadani.

Nënkryetari Rudari ka thënë se në këtë takim ka paraqitur shqetësimin e tij në lidhje me masat e ndërmarra për mbylljen totale të bizneseve për fundjavë, në theks për sektorin e gastronomisë, njëkohësisht është angazhuar për respektim strikt të masave anti-Covid nga qytetarët dhe organet përgjegjëse të komunës, që të shmangen mbylljet totale siç u praktikuan në fundjavë.

Rudari ka pohuar se komuna është e gatshme për t'i shtuar

masat e kontrollit dhe të sigurisë në bashkëpunim me policinë, inspektoratin dhe punëtorët shëndetësorë.

Epidemiologjia Bedrie Rama ka theksuar se gjendja me pandeminë aktualisht është e menaxhueshme, pavarësisht shtimit të numrit të rasteve.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Podujevë, Bejtush Jashari, ka pohuar se ka angazhim të plotë të stafit mjekësor, kurse kohët e fundit ka edhe shtim në staf të vullnetarëve, të cilët po punojnë pandërprerë në luftimin e pandemisë. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Arsimit,



Agim Blakçori, tha se deri tani procesi mësimor është duke u zhvilluar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve shëndetësore. Sipas tij, nga 114 testimet e kryera të personeli arsimor, 31 punëtorë arsimorë kanë

rezultuar pozitivë, kurse të nxënësit, prej 98 testimeve, 23 raste kanë dalë pozitivë me Covid-19.

Shtabi emergjent u ka bërë thirrje qytetarëve të Komunës së Podujevës që t'i respektojnë masat anti-Covid.

Komuna e Prizrenit ndan dru për ngrohje për 700 familje

PRIZREN, 10 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (DPMS), Islam Thaqi, kanë filluar shpërndarjen e druve për ngrohje për familjet e dëshmorëve, të invalidëve të luftës dhe familjeve në nevojë. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka theksuar se duke marrë parasysh edhe situatën pandemike që ka ndikuar negativisht në gjendjen ekonomike të qytetarëve, Komuna e Prizrenit këtë vit ka ngritur numrin e përfutësve nga ky projekt, ku 700 familje do të furnizohen me nga tri metra dru nga DPMS-ja. Po ashtu, kryetari Haskuka deklaroi se për t'u dhënë ndihmë sadopak



familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe familjeve në nevojë, do ta vazhdojnë edhe shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike.

Komuna e Gjakovës ka përmbushur 96.2 për qind të planit të veprimit për transparencë komunale

Gjakovë, 10 nëntor (ER) - Komuna e Gjakovës ka përmbushur 96.2 për qind të planit të veprimit për transparencë komunale, konkretisht ka kryer gati të gjitha detyrat lidhur me respektimin e udhëzimit administrativ për mirëmbajtjen e uebfaqes zyrtare. Ky vlerësim

maksimal është bërë nga Lëvizja Fol në kuadër të zbatimit të projektit për transparencë komunale të mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung Prishtina Office. "Faleminderit qytetarëve dhe administratës komunale për bashkëpunimin e ndërsjellë", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.



Rregullohet hyrja në qytetin e Malishevës në rrugën 'Ibrahim Mazreku'

MALISHEVË, 10 NËNTOR (ER) - Rruga "Ibrahim Mazreku", përkatësisht pjesa e hyrjes jugore në qytetin e Malishevës, është duke u rregulluar me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke filluar me ndriçim, kanalizimet për ujërat e zeza dhe ujërat e shiut dhe trotuari.

Punimet në këtë rrugë i kanë inspektuar drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, dhe shefi i prokurimit, Nuhi Shala, ku janë njoftuar me ecurinë e punimeve dhe realizimin e projektit sipas kontratës dhe paramasave. "Kjo rrugë ka qenë prioritet i drejtorisë së urbanizmit dhe tani janë duke u realizuar punimet sipas planifikimeve me qëllim të rregullimit të hyrjes në qytet e,

mbi të gjitha, për të krijuar edhe siguri në këtë rrugë, pasi përmes rregullimit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, e bashkë me këtë edhe trotuari dhe ndriçimi, nuk do të ketë dalje të ujërave në rrugë, po ashtu edhe hapësirë dhe ndriçim për këmbësorët", ka thënë drejtori Morina gjatë inspektimit të punimeve.

Morina, gjithashtu, është ndarë i kënaqur me ecurinë dhe cilësinë e punimeve që janë duke u realizuar në këtë rrugë, e rregullimi i saj ka qenë një kërkesë dhe nevojë e domosdoshme, pasi në këtë pjesë shtrihen shumë objekte me rëndësi, siç është objekti i shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimin, objekti i pylltarisë dhe



objekte të ndryshme afariste e, po ashtu, është një prej rrugëve më të ngarkuara me qarkullim të

automjeteve. Rregullimi i ndriçimit, kanalizimit dhe trotuari në hyrje-daljen jugore të

Malishevës mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Presidenti i ri Joe Biden do ta nxisë zhvillimin e demokracisë



Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KİÇMARI

Zgjedhja e Joe Bidenit president i Shteteve të Bashkuara është lajm shumë i mirë për demokracinë në botë. Edhe Kosova dhe shqiptarët mund vetëm të përfitojnë nga ndryshimi i administratës së ShBA-së.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, para ardhjes në pushtet lansoi platformën "Amerika së pari" (angl. America first). Kjo u interpretua nga analistë të shumtë si një paradigmë nacionalcentrike dhe izolacioniste. Presidenti Trump sinjalizonte përmes saj që vëmendja e politikës së jashtme e ShBA-së duhej përqendruar në interesin ekonomik dhe tregtar në marrëdhëniet me vendet e tjera. Demokracia, si elementi qenësor i ndikimit në botë të ShBA-së, u shmang nga prioritetet në katër vjetët e kaluar. Qëndrimi i tillë pati një reflektim në drejtim të rritjes së autoritarizmit, nacionalizmit dhe iliberalizmit në Evropë dhe gjithandej globit. Besimi në demokraci filloi të zbehej. Sistemi ndërkombëtar i ndërtuar dhe udhëhequr nga ShBA-ja prej deceniesh po shpërbëhej. Sfidat me karakter të rëndësishme globale, si ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, migracioni masiv, revolucioni teknologjik në zhvillim dhe sëmundjet infektive në nivel pandemie, nuk mund të menaxhoheshin dot sipas parimit nacionalcentrik.

Mosangazhimi tradicional i ShBA-së për zhvillimet demokratike u reflektua gjithandej globit. Freedom House ka deklaruar se 22 nga 41 shtete që janë konsideruar si shtete të lira demokratike, në pesë vjetët e fundit kanë rrëshqitur drejt autokracisë. Rusia nga një shtet "pjesërisht i lirë" është renditur në kuadrin e shteteve "jo të lira", kurse Turqia, e cila konsiderohej si "pjesërisht i lirë", është renditur në kuadrin e shteteve "jo të

lira". Nga një vend "i lirë" në kuadrin e vendeve "pjesërisht të lira" është radhitur edhe Hungaria, që është anëtare e BE-së.

Por, presidenti i ri amerikan do të detyrohet të ndeshet edhe me një numër të madh sfidash për ta rikthyer politikën amerikane nga centrismi në drejtim të institucionalizmit ndërkombëtar. Hapi i parë i paralajmëruar është rikthimi i besimit të partnerët tradicionalë të ShBA-së në Evropë, Australi, Japoni dhe Kanada. Vetëm përmes një rikthimi drejt partneritetit mund të sigurohet sërish roli drejtues i ShBA-së drejt vlerave demokratike në Evropë dhe kudo në botë. Platforma "America first" pritet të zëvendësohet me sintagmën "America together with his partners".

Për angazhimin e tij për zgjerimin e demokracisë kudo në botë presidenti Biden do të ndeshet në rrafshin politik me shtetet diktatoriale, autoritare ose, siç i konsideron Freedom House, me shtetet jo të lira. Në këtë radhë hyjnë Republika Popullore e Kinës, Rusia, Irani, Kuba dhe një numër i madh i vendeve të Azisë dhe Afrikës si dhe disa nga vendet e Amerikës Qendrore dhe Jugore.

Ndryshe nga presidenti Trump, i cili pati një sjellje tejet të kujdesshme në marrëdhëniet me Rusinë dhe presidentin autokrat rus Putin si dhe me liderin koreno-verior Kim Jong-un, presidenti Biden pritet të mbajë qëndrim shumë më të ashpër ndaj Rusisë dhe Koresë së Veriut, në mbrojtje të vlerave demokratike. Bideni është një mbështetës shumë i madh i Ukrainës në konfliktin me Rusinë dhe pritet që ai nuk do ta mbështesë rikthimin e Federatës Ruse në grupin e vendeve të zhvilluara G-7 pa ndryshimin e politikës së saj ndaj Ukrainës. Koreja e Veriut do të ndeshet me presione të mëdha për t'i ndalur provokimet e saj ndaj Koresë së Jugut dhe vendeve të tjera përmes testeve të saj nukleare. Raportet e ShBA-së me Kinën do të vazhdojnë të jenë ambivalente. Bideni e njeh shumë mirë liderin kinez Xi Jinping. Ka kaluar shumë orë diskutimesh me të në të kaluarën. Ai, në njërin anë, do të angazhohet ta kundërshtojë shtrirjen e ndikimit kinez, duke promovuar modelin e saj autokratik njëpartiak; do të

kritikojë qeverinë kineze për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kinë, sidomos përmes të ashtuquajturave "kampe të riedukimit" në rajonin e popullsisë uigure në Xinjiang dhe shtypjes brutale të të drejtave të popullit të Tibetit; do të ndërmarrë masa ndaj vjedhjes së pronës intelektuale në fushën e teknikës dhe teknologjisë nga kompanitë kineze; por në anën tjetër do të mundohet që me Kinën të bashkëpunojë në fusha të interesit global siç janë masat kundër ngrohjes globale, mospërhapja e armëve dhe siguria globale, luftimi i përbashkët i pandemisë etj. Në angazhimin e tij për të dobësuar ndikimin kinez në rrafshin tregtar dhe politik, Biden do të fokusohet për të krijuar një koalicion me aleatët perëndimorë, Japoninë, Australinë dhe Kanadanë.

Si një nga politikanët më me përvojë në ShBA, presidenti i ri Joe Biden pritet të përdorë diplomacinë si instrument për të realizuar interesat amerikane dhe etabluar demokracinë në botë. Siç ka paralajmëruar vet do të rikthehet te Marrëveshja e Parisit për Mbrojtjen e Klimës, Marrëveshja P5+1 për Iranin, do të rivendosë rolin udhëheqës të ShBA brenda NATO-s, do të rikthehet në Partneritetin Trans-Atlantik me 11 vendet e Azisë dhe Oqeanisë, do të rikthejë anëtarësinë në UNESCO, të suspenduara nga administrata e presidentit Donald Trump etj.

Presidenti i zgjedhur Joe Biden ka premtuar se do ta rivendosë kulturën tradicionale të veprimit të ShBA në rrafshin e demokracisë. Gjatë vitit të parë të mandatit të tij do të organizoj një Samit Global për Demokracinë, për të ringjallur frymën demokratike dhe mbështetur demokracinë në botë. Luftimi i korrupsionit, vendosja e transparencës financiare në sistemin global financiar, mbrojtja kundër autoritarizmit dhe autokracisë si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut gjithandej botës do të jetë synimi i Samitit.

Dhe, për të përshkruar atë që pritet të ndodh për forcimin e demokracisë, le të shërbehemi me fjalët e vet presidentit Biden: "Putini dëshiron t'i thotë vetes dhe cilitdo tjetër që mund ta besojë atë, se ideja liberale është "e vjetruar". Por ai e bën këtë sepse ka frikë nga fuqia e saj. Asnjë ushtri në tokë nuk


mund të përputhet me mënyrën se si ideja energjike e lirisë kalon lirshëm nga personi në person, kërcen kufijtë, kapërcen gjuhët dhe kulturat dhe mbingarkon bashkësitë e qytetarëve të zakonshëm në aktivistë dhe organizatorë dhe veprimtarë të ndryshimit. Ne duhet ta shfrytëzojmë edhe një herë atë fuqi dhe të bashkojmë botën e lirë për të përmbushur sfidat me të cilat përballet bota sot. U bie Shteteve të Bashkuara për të udhëhequr rrugën. Asnjë komb tjetër nuk e ka atë kapacitet. Asnjë komb tjetër nuk është ndërtuar mbi atë ide. Ne duhet të mbështesim lirinë dhe demokracinë, të rimarrim besueshmërinë tonë dhe të shohim me optimizëm dhe vendosmëri të paepur drejt së ardhmes sonë".

Një iniciativë e tillë e presidentit Joe Biden duhet aplauduar edhe në rajonin tonë. Për fat të keq, të gjitha vendet e rajonit të Evropës Juglindore, që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, nga Freedom House janë renditur si vende "pjesërisht të lira": Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia. Nevoja

për një investim serioz në drejtim të demokracisë në Evropën Juglindore është imanente.

Kosova ka potencial për të lëvizur nga shtet "pjesërisht i lirë" në një "shtet të lirë" demokratik. Qytetarët e Kosovës kanë dije dhe kulturë për të mbështetur përparimin e demokracisë. Elita politike e Kosovës duhet të fokusohet shumë drejt konsolidimit të saj demokratik: luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, forcimin e sistemit të drejtësisë dhe rikthimi drejt stabilitetit institucional, të legjitimuar përmes votës qytetare. Jam i sigurt se mbështetja e presidentit Joe Biden dhe administratës së re nuk do të mungojë.

Fitorja e presidentit Joe Biden pritet të ketë reflektime serioze edhe në bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Presidenti Biden i njeh mirë jo vetëm gjeografinë, por edhe historinë dhe politikën e Kosovës. Ai e di, më mirë se shumë aktorë të tjerë ndërkombëtarë, burimin e konfliktit në mes të Kosovës dhe Serbisë.





Filozofia letrare e Anton Pashkut

Nga: Petrit PALUSHI

Anton Pashku mbetet një prej shkrimtarëve me të dallueshëm shqiptarë të shekullit të njëzetë, një lloj fenomeni letrar me një prirje të vazhdueshme drejt përsosmërisë artistike; vepra e tij përmban shumësinë e mendimit, shumësinë figurative të fjalës dhe njëkohësisht vetëdijen e lartë estetike të ngritur deri në model. Vetë shkrimtari pat shënuar se “Gjuha e veprave artistike nuk është dhe nuk mund të jetë një “gjuhë normale”. Ajo nuk është e tillë as atëherë kur, fjala vjen, artisti i fjalës merr e shkruan për “gjërat më normale” nga jeta e njeriut. Shenjat e gjuhës së tij janë shenja të gjuhës poetike. Kur janë të ngjeshura mirë e mirë pranë njëra-tjetrës, këto shenja krijojnë aso relacionesh të reja që mund të kyçin ndër to eksplozionet e panumërta jetësore që kanë intensitete shumë të larta”.

Anton Pashku, shkrimtari modern i letrave shqipe, stilisti i dallueshëm i mëvetësisë, të cilit, pavarësisht nga rrjedha e viteve, s’mund t’i pakësohet a s’mund t’i firojë asgjë prej shkrimeve të tij; kjo ka të bëjë me aftësinë e artit të mbijetesës, cilësi vetëm e shkrimtarëve të vlerave të veçanta estetike. Ai ka zënë

vend në zonën më të epërme të letrave shqipe, aty ku vlerat e vërteta estetike kanë krijuar zonën e tyre të të ekzistuarit, zonën vepruese, të pacënueshme nga zhurma e viteve, nga vepruesit jashtëletrarë, më saktë, nga zhurmuesit e tillë, të cilët kanë vepruar sistematikisht, pavarësisht se pa rezultat, mbi disa nga përfaqësuesit më të cilësishëm të letërsisë sonë.

1.

Prej shkrimit të parë në “Jeta e re” më 1955, vepra e tij letrare u formësua si një vepër e identitetit të lartë artistik, kryesisht në prozë dhe në gjininë e dramës: “Tregime”, 1961, “Nji pjesë e lindjes”, 1965, “Kulla”, 1968, “Sinkopa”(dramë), 1969, “Oh”, 1971(botimi i katërt më 1990), “Kjasina”(tregime të zgjedhura), 1973, “Gof”(dramë), 1976, “Lutjet e mbrëmjes”(tregime të zgjedhura), 1976, “Tragjedi moderne”(drama), 1982, ndërsa kompletin e veprave të tij e botoi “Rilindja” më 1986, sipas renditjes: 1. Tregime fantastike; 2. Romani “Oh”; 3. Tragjedi moderne, dhe njëkohësisht duke mos përmendur në këtë paraqitje ribotimet e tjera të librave të tij. Vepra letrare e Anton Pashkut, është ngritur në lartësinë e

tekstit artistik, dhe si i tillë, ky tekst, do parë në të gjitha shtresimet dhe nënshtresimet e tij, për t’u vërejtur sa më mirë dhe sa më plotë mesazhi, vlera e tij kumtuuese. Për të arritur në këtë nivel të tekstit artistik, në një shkallë të tillë cilësie, një kuote të tillë vlerash artistike, përveç talentit dhe shijes shumë të lartë, shkrimtari i është dashur një regjim i jashtëzakonshëm pune në krijimtari. Sipas një dëshmie “Ai kishte regjim të posaçëm të punës në krijimtari. Antoni ishte shumë i disiplinuar. Kishte kondicion të madh për punë. Punën e bënte me përkushtim të madh, donte që ajo t’i përfundonte sa më mirë. Bie fjala, romanin “Oh”, e ka shkruar në variantin e parë në 800 faqe, më vonë, duke e përpunuar e duke e ngjeshur tekstin përmbajtësisht, atë e përfundoi në rreth 170 faqe”(Rilindja, 9 nëntor 1996, f.8).

Nga ana tjetër, aty kah vitet ‘80, së bashku me një grup krijuesish të tjerë, ngrihet fuqimisht kundër ideologjizimit të artit, që shkaktoi trandje në krejt mjediset letrare.

2.

Vepra letrare e Anton Pashkut (në tri njësitë: në tregime, në romanin “Oh”, në dramë

“Sinkopa” dhe “Gof”, prezenton në mënyrën më të përkryer dramatikën e jetës, pavarësisht nga zhvendosja e saj nëpër kohë të ndryshme dhe duket sikur është një kohë e palëvizshme dhe si e ngrirë, dhe në këtë kontekst, ajo prezenton fatin e njeriut në përgjithësi, si individ apo si kolektivitet njerëzor. Më saktë, ai kundron rrethin ekzistencial të njeriut dhe formëson një tekst të tillë letrar ku mund të nxirren segmente të shumtë kuptimorë. Edhe pse një vepër letrare vështirësisht e kuptueshme, kjo për shkak të intelektualizmit të lartë në procedun krijues, ajo ka bërë vendin e vet në zonën më estetike të letërsisë sonë, në atë zonë ku letërsia mund të përcillet vetëm letërsi dhe vetëm në funksionin e saj.

Në veprën e Pashkut ka simbolikë dhe përmes saj kundrohet fati i mjedisit, fati personazheve; në rast se hiqet mbulesa e simbolikës, mund të kundrohet më me lehtësi kthjelltësia e mjedisit dhe e personazheve. Në veprën e Pashkut, mitet sikur preken, kthjelltohen. Në veprën e tij hetohet atmosfera artistike, një atmosferë krejt sugjestive, me një harmoni a kombinim ngjyrash, që mund të shërbenin si dekor në lëvizjen e jetës dhe vdekjes, dhe natyrisht, këto shumë pranë

njëra-tjetrës. Por, më tepër se e ndjenjës, vepra e Pashkut është vepër e mendimit dhe dendësia e saj mbërrin në kufijtë më të dukshëm të maksimales.

Ndërsa, realizimi i një teksti cilësisht të lartë, është arritur vetëm përmes një pune të studiuar intësisht. Këtë gjë e ka shpjeguar vetë autori për një nga veprat e tij: “Në dramën “Gof”, për shembull, zbatova matematikën dhe teorinë e ngjyrave. Mirëpo, së pari, shfletuam të gjitha gazetat e periudhës ‘37-’38-’39. E thithëm krejt atë pluhur. Tek pastaj, fillova të përdor trekëndëshin: kjo vjen deri këtu, kjo tjetra mbërrin deri aty. Saktë e përcaktoja intensitetin e shprehjes...”

3.

Pa kurrfarë dyshimi është mbërritë në mendimin se Anton Pashku mbetet njëri prej stilistëve më të mëdhenj në letërsinë tonë.

Vepra e tij është parë në shumë anë a kënde venerimi, çka flet se kjo vepër është kthyer në një pikë referimi të vazhdueshme. Dendësia e mendimit dhe estetika e lartë e tekstit, ka bërë që shpesh vepra e tij të jetë vështirësisht e kuptueshme, çka tregon gjithashtu se vepra e tij s’është lehtësisht e perceptueshme, siç dëshmon gjithashtu se teksti i tij, qoftë në

dramë, në prozë të shkurtër apo dhe në romanin "Oh", kërkon një rilexim apo një vëmendje maksimale në të lexuar.

Vlerësimet për këtë vepër janë të shumta dhe kritika letrare (kryesisht në Kosovë) e ka ndjekur admirueshëm krijimtarinë e tij ç'prej fillimeve, pavarësisht se një vepër letrare si e tij, ose më mirë, një vepër letrare si e Anton Pashkut, kërkon vlerime pas vlerimesh. Me të drejtë është konstatuar se "Anton Pashku mbetet Xhojsi i letërsisë shqipe" (I. Rugova); "Përdor metodën e shkrimtarëve të shquem të Perëndimit dhe asht nën ndikimin e tyre. Veprat e e Foknerit dhe Xhems Xhojsit, Tomas Vulfrit dhe të tjerëve, ma tepër shkrimtarë anglo-amerikanë, të cilët i ka pasë si lekturë në takimet e përditshme me librin-kanë ndikuar ma shumë se të tjerët" (H. Mekuli).

Në Shqipërinë e para viteve '90, kur në letërsi socrealizmi kish frymë mbizotëruese, as që mund të bëhej fjalë për qarkullimin e veprës së Pashkut: tek-tuk ndonjë tregim i botuar dhe gjithçka tjetër e mbuloi heshtja.

Sidoqoftë, afërsisht e njëta gjë edhe në këto 30 vite të hapjes së Shqipërisë, një lloj anatemimi krejt i pashpjegueshëm, cinik: asnjë vepër e tij s'është botuar ende në Tiranë, kur në Prishtinë vepra e tij është botuar dhe ribotuar disa herë, duke përfshirë këtu edhe botimin për nxënësit e shkollave të mesme në kolanën "Lekturë shkollore". Mosbotimi i veprës së Pashkut në Shqipëri, ka bërë që vepra e tij të njihet pak dhe

njëkohësisht menjanimi i kësaj vepre të cilësishme, i sjell dëm vetë letërsisë shqipe në radhë të parë. Për shembull, në shkollat e mesme, krijimtaria e tij letrare përfaqësohet vetëm me tregimin "Kulla", kur tashmë është konsoliduar mendimi mbi vlerat estetike të shumë prej tregimeve të tjera të tij, të romanit "Oh" apo dhe të dramave "Sinkopa" dhe "Gof".

4.

Anton Pashku u nda nga jeta më 31 tetor 1995.

Ai la pas një vepër solide letrare, me shfaqjen e saj më të dukshme të modernitetit. Vepra e tij letrare mbetet njëkohësisht një nga shfaqjet më të dukshme të mjeshtrisë letrare dhe duke pasur në vetvete një prirje të vazhdueshme për kah përsosja e tekstit artistik. Si çdo krijimtari e madhe dhe që dallohej menjëherë prej letërsisë vegjetuese, të përkohëshme, të letërsisë për letërsi, u fut dalngadalë në rrethin e vlerave estetike më të qëndrueshme të letrave shqipe.

Ndërsa, në çdo përvjetor të vdekjes së A. Pashkut, dy vargje të poetit Mirko Gashit:

"Askush si ti

Nuk i dirigjoi Odën e Gëzimit", të shkruar pak ditë mbas vdekjes së A. Pashkut, mund të tingëllojnë a mund të merren si lutje a si përshtirje për njeriun dhe shkrimtarin ekskluziv të modernitetit të letrave shqipe, ekskluziv për kah fryma letrare, për kah ndriçimi i fjalëve, i frazës, i figurave, i kuptimshmërisë.

Shkurt, për shkrimtarin që krijoi harmoni artistike në krejt veprën e vet. /Gazeta "ExLibris"/

Filmi 'Mank': David Fincher i rikthehet mitit të Qytetarit Kejn

Gary Oldman luan skenaristin cinik Herman J Mankiewicz, në një film të xhiruar për së mbari e që shfaq sa epokën e artë të Hollivudit aq edhe korrupsionin e tij. Pjesë të shkrimit të kritikut të filmit Peter Bradshaw



Gary Oldman si Herman Mankiewicz

David Fincher e ka ëndërruar jetën e skenaristit hollivudian, Herman J Mankiewicz; rezultati duket i mirë, ndërsa tingëllon edhe më mirë. Është një fabrikim monokromatik, pikërisht i llojit të filmave të epokës së artë të Hollivudit të viteve 1930-'40 me të cilët Mankiewicz punonte, ndonjëherë pa u paguar, derisa nuk e kap shansin për të krijuar një kryevepër autentike të vitit 1941: "Citizen Kane" (Qytetari Kejn). Më në fund ai e merr mirënjohjen e bashkautorësisë (grindavece) me Orson Welles-in, duke e ndarë me të çmimin Oscar për skenarin më të mirë origjinal.

Në filmin "Mank", Gary Oldman e luan Mankiewicz-in – me cinizmin e tij të zhurmshtëm, flokë të çrregulluara, shakatë e hidhura dhe zbatat e ndikuara nga alkooli sa që shpesh e dikton skenarin e Kejnit nga shtrati i një invalidi (duke ju kujtuar, çuditërisht, performancën e Oldman-it si Winston Churchill). Tuppence Middleton na ofron një rol të mirë e të ndjeshëm të gruas së tij të shumëvujtur, Sara. Marion Davies – me të cilin Mankiewicz ishte njohur përmes lidhjes së tij me nipin e saj, skenaristin Charles Lederer – luhet nga Amanda Seyfried, ndërsa i dashuri i saj i moshuar, William Randolph Hearst – plutokrati i moçëm i medias dhe vetë modeli i Kejnit – luhet nga Charles Dance (figurë më e hijshme sesa origjinali). Tom Burke e luan Welles-in. Është ky një film që shihet me zemër, i parzistueshëm e që rastësisht

shërben për një teori kuazi-Rosebud (fjala e fundit që thotë Kejn në filmin origjinal, që nxit intrigën e një kërkimi e që shpërfaq jetën e rreme të një manjati të mediave – v.j.) rreth gjenezës së Kejnit.

Fincher e krijon versionin se Mankiewicz-i e shkroi skenarin teksa ishte i shtrirë me një këmbë të thyer, pas një aksidenti automobilistik. Në fakt, ai nisi ta shkruante pasi u shërua nga dëmtimi, por Fincher këmbëngul në këtë – për ta shkruar në izolim mjekësor e për të theksuar këtë ide të autorësisë së tij të vetme.


Është ky film i përzemërt dhe ekstravagant për një reporter që u bë skenarist e i cili deri në fund nuk i ka marrë meritat që i takojnë e që madje është lënë në hije. Por, a mundet që shkrimtari i zgjuar, i mençur e i lënduar që luhet nga Gary Oldman, të mos jetë... Herman Mankiewicz? Skenari është shkruar nga babai i ndjerë i David Fincher-it, Jack Fincher, që ishte gazetar dhe redaktor i revistës "Life" e që vdiq nga kanceri më 2003. Skenari i mëparshëm i tij, për jetën e Howard Hughes-it, u përzgjodh për filmin "The Aviator" të regjisorit Martin Scorsese – derisa nuk u refuzua në favor të një versioni rival (i shkruar nga John Logan – v.j.).

Duhet të theksohet se Mankiewicz dhe vëllai i tij më i realizuar, regjisor Joseph, kishin frikë nga babai i tyre, studiuesi Franz Mankiewicz, i cili kishte kërkesa të tmerrshme perfeksioniste ndaj djemve të tij. Këto kërkesa thuhet se e

frymëzuan Joseph-in të shkëlqejë e Herman-in të maskonte me cinizëm dhe me pije alkoolike ndjenjat e tij të lënduara.

Mankiewicz-i i imagjinuar këtu është dikush që nuk e humbi kurrë ndjenjën e gazetarit për botën përreth tij dhe paudhësitë dhe pompozitetet e politikanëve. Në veçanti, ai është i zemëruar nga filmat propagandistikë me lajme të rreme të paraqitura nga studiot e Hollivudit (me mbështetjen e Hearst-it) për të diskredituar autorin socialist Upton Sinclair në garën e vitit 1934 për guvernator të Kalifornisë, duke krijuar intervista të rreme populiste. Pa e theksuar shumë këtë, filmi na jep pamjen e një Mankiewicz-i të neveritur nga Hearst-i.

Se sa bukur duket ky film, është e mundur të kalosh në një lloj ekstazë: një shfaqje magjepsëse e krijuar nga mjeshtri i fotografisë Erik Messerschmidt, skenaristi Donald Graham Burt, e kostumografja Trish Summerville. Është kjo një pamje jo e zakonshme e Hollivudit – pikëpamja e tanishme është ndoshta më shumë në përputhje me miniserialin e Ryan Murphy-it, "Hollywood", që ka të bëjë me korrigjimin e përjashtimeve që u janë bërë të gjithëve jashtë sistemit të bardhë-heteroseksual, por kjo nuk është ajo që "Mank" përshkruan. Por, është një drame romantike që krijon varësi, duke e përzier ndjeshmërinë me rrëmbimin njerëzor. /Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Miqësorja kundër Shqipërisë, parapërgatitje për kualifikueset e Botërorit 2022

Trajneri Bernard Challandes ka thënë se miqësorja vëllazërore ndaj Shqipërisë është e mirëseardhur për Përfaqësuesen e Kosovës pasi synim është të shfrytëzohen sa më shumë ndeshjet e tilla për përgatitje për kualifikueset e Botërorit 2022. Në linjë të njëjtë me përzgjedhësin zviceran ka qenë edhe kapiteni Amir Rrahmani. "Besoj se këto tri ndeshje do të na ndihmojnë shumë që të përgatitemi sa më mirë për ndeshjet kualifikuese të Botërorit 2022", ka thënë mbrojtësi i Napolit



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes dhe kapiteni Amir Rrahmani janë paraqitur në konferencë për media para ndeshjes miqësore kundër Shqipërisë, e cila zhvillohet sot (e mërkurë) në orën 16:00 në stadiumin "Elbasan Arena".

Trajneri zviceran ka thënë se ndeshja ndaj Shqipërisë është e mirëseardhur për Kosovën në këtë kohë aspak të lehtë ku, përveç pandemisë Covid-19, "dardanëve" u kanë munguar edhe rezultatet. "Shqipëria ka vërtet ekip të mirë dhe më herët ka pasur sukses të madh, por nganjëherë suksesi është edhe i rrezikshëm dhe këtë ua kam thënë edhe lojtarëve të mi, pasi kjo ka ndodhur me Shqipërinë. E kam të qartë se disa prej tyre nuk do të jenë në këtë takim, por prapëseprapë Shqipëria mbetet kundërshtarë shumë e fortë dhe besoj se është

kundërshtarja e duhur për neve në këtë periudhë", ka thënë Challandes. "Për ndeshjen me Shqipërinë i kam në dispozicion 21 futbollistë dhe kjo është e mjaftueshme. Do ta bëjmë përzgjedhjen e lojtarëve në bazë të minutave që kanë me klubet e tyre. Nëse kemi probleme të tjera, atëherë do ta shohim nëse kemi nevojë për lojtarë të tjerë. Do ta shohim situatën e Paçaradës, nëse mund ta arrijmë një marrëveshje me regjionin e Hamburgut që ta lëshojë atë dhe të mos karantinohej kur të kthehet. Pastaj, duket parë edhe situatën e Idriz Vocës, nëse do të jetë i gatshëm pas lëndimit që ta përfshijmë eventualisht në ekip për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve", ka shtuar Challandes, i cili është rikthyer të flasë edhe një herë tjetër për humbjen që kishte pësuar Kosova në ndeshjen ndaj Maqedonisë së Veriut. "Tani jemi në një fazë tjetër. Jemi në grumbullimin e fundit për këtë vit që do ta na shërbejë për të

provuar t'u përmbahemi vlerave tona dhe të tregojmë atë që kemi ndërtuar, po ashtu këto ndeshje janë edhe një lloj përgatitje për kualifikimet e Botërorit 2022", ka deklaruar Challandes.

Në Përfaqësuesen A për herë të parë është ftuar sulmuesi Mirlind Daku, i cili ka shkëlqyer në këtë edicion me fanellën e Ballkanit, duke qenë lojtari më i mirë në Superligë me 17 gola të shënuara në njëmbëdhjetë ndeshje të zhvilluara. "Daku ka luajtur ndeshje të mira, është i ri dhe ka shënuar shumë gola. Kështu që, më duhej ta ftoj. Për mua është e rëndësishme t'i ftoj lojtarët më të mirë, jo për t'u dhënë kënaqësi. Pasi nuk kemi shënuar shumë gola me kombëtaren dhe ai ka shënuar, kjo është arsyeja që e kemi ftuar. Dua të kem konkurrencë sa më shumë në ekip", ka thënë Challandes. Ndërsa kapiteni Amir Rrahmani ka thënë se tri ndeshjet e nëntorit do t'i shërbejnë Kosovës që të përgatitet sa më mirë për

kualifikueset e Botërorit 2022 që do të nisnin në mars të vitit të ardhshëm. "Besoj se këto tri ndeshje do të na ndihmojnë shumë që të përgatitemi sa më mirë për ndeshjet kualifikuese të Botërorit 2022, sepse e dimë se do të kemi kundërshtarë shumë më të fortë sesa ne, së paku që janë të renditur më mirë në ranglistën e FIFA-s, andaj këto ndeshje do të na ndihmojnë shumë në këtë drejtim", ka thënë Rrahmani.

Reja: Me dëshirë do ta shmangia miqësoren me Kosovën

Trajneri i Shqipërisë, Edy Reja, ka thënë se me dëshirë do ta shmangte miqësoren ndaj Kosovës. "Është një ndeshje e ndier nga të dyja tifozëritë. Do të përpiqem të hedh në fushë një formacion konkurrues. Do të doja që të mbetej miqësore dhe mos ketë më shumë grintë se ç'duhet. Po të kisha mundësi, do ta shmangia miqësoren me

Kosovën, por s'kishim alternativa të tjera. U gjendëm në një çast të vështirë", ka thënë Reja, i cili ka zbuluar se ende nuk ka vendosur për formacionin.

Portieri i Shqipërisë, Etrit Berisha, të martën ishte i pranishëm në konferencë për media para ndeshjes miqësore me Kosovën. Portieri nga Prishtina ka thënë po sikur shqiptarët të kishin vetëm një kombëtare, atëherë nga ajo do ta kishte frikë e gjithë Evropa. "Nuk është e lehtë të luajmë me Kosovën. Kur merret parasysh që është vëllazërore, gjërat merren më qetë. Nëse do të ishte ndeshje kualifikuese, do të ishte shumë e vështirë. Si Kosova, si Shqipëria, është vend im. Gjithmonë kam shkuar me bindjen që t'i përfaqësoj të dy vendet. Uroj të bëhet një ekip, sepse do të bëhej super ekip, që do ta respektonte dhe do ta kishte frikë gjithë Evropa. Fatkeqësisht, ndodhemi në një gjendje tjetër dhe duhet ta shikojmë situatën aktuale. Ta luajmë këtë ndeshje si vëllazërore", ka thënë Berisha.

Sonte dy ndeshje në Superligë

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e katërt në Prince Caffè Superligë, ku do të ketë takime mjaft interesante. Sfidë interesante është përballja mes rivalëve të vjetër Pejës dhe Bashkimit. Pejanët e kanë nisur për mrekulli edicionin e ri, duke shënuar tri fitore në tri ndeshjet e para, kurse prizrenasit kanë një fitore dhe dy humbje. Andaj kjo përballje në Pejë pritet të jetë mjaft interesante. Rahoveci - Ponte Prizreni është një tjetër

sfidë interesante e xhiros së katërt. Vreshtarët kanë dy fitore dhe një humbje në edicionin e ri, kurse prizrenasit një fitore dhe dy humbje në tri ndeshjet e para. Ndeshje interesante është edhe ajo në mes të Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit, dy skuadra që shpresojnë të kenë një edicion sa më pozitiv. "Bardhekaltrit" kanë një fitore dhe dy humbje, kurse therandasit dy fitore dhe një humbje. Vëllaznimi - Trepça, po ashtu, shihet si sfidë shumë



PRINCE CAFFE SUPERLIGA - Java 4

Të mërkurë takohen:
19:30 Peja - Bashkimi
19:00 Vëllaznimi - Trepça

Të enjten takohen:
19:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli
19:00 Rahoveci - Ponte Prizreni

interesante. Këto dy skuadra në mesjavë shënuan fitoret e para në kampionat dhe përballja mes tyre do të jetë shumë interesante.

Xhaka: Arteta me mbajti në Arsenal

LONDËR, 10 NËNTOR - Granit Xhaka ishte shumë pranë largimit nga Arsenal kur në stolin e topçinjve ishte Unai Emery. Trajneri spanjoll i jepte pak minuta në fushë, ndërkohë që në atë periudhë mesfushori me origjinë shqiptarë pati një zënkë edhe me tifozët. Por, me marrjen e

drejtimit të Arsenalit nga Mikel Arteta gjërat ndryshuan pasi me ish-mesfushorin në bankinë Xhaka u rikthye të jetë një lojtar shumë i rëndësishëm për skuadrën londineze ndërsa, siç shprehet vetë, Arteta e ka bërë një futbollist më të mirë në çdo drejtim.

“Jam një njeri që provoj emocione dhe ka gjëra që më lëndojnë. Gjestin që bëra atëherë ndaj tifozëve nuk do ta bëja kurrë sot. Nuk u stërvita për dy ditë radhazi dhe me zemër isha larg Arsenalit. Nëse ndodhem akoma këtu, kjo është vetëm për meritë të Artetës. Më

pyeti se si ndihesha dhe më kërkoi se pse e bëra atë gjest. Tentova t’i shpjegoja gjendjen time shpirtërore dhe pse isha sjell ashtu. Ishte diçka shumë e rëndësishme për mua, pasi asnjë tjetër nuk më kishte pyetur kurrë më parë për diçka të tillë”, ka thënë Xhaka.



Derbi përfundon baras, fitojnë Drenica dhe Llapi



“Epoka e re”

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Derbi i Superligës së Kosovës në futboll në mes të Dritës dhe Prishtinës përfundoi pa fitues (0-0). Skuadra kampione, Drita, pati një mundësi të mirë që të kalojë në epërsi në pjesën e parë, por Erjon Vucaj dështoi të realizojë nga penalltia. Pjesa e dytë u përshkrua me pak raste shënimi, kurse rastin më të mirë për vendësit nuk e shfrytëzoi sulmuesi Kastriot Rexha, pasi topi i goditur me kokë përfundoi në shtyllë. Pas kësaj ndeshjeje, Drita vazhdon të jetë në pozitën e dytë me 23 pikë, kurse Prishtina është në vendin e pestë me 15 pikë. Fitore të madhe të martën arriti Drenica në përballje me rivalët

e Feronikelit, duke shënuar golin e fitores në minutën 90. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll me rezultat 0-0, kurse vendasit shënuan fitore me autogolin e shënuar nga Argjend Malaj në minutën e fundit të kohës së rregullt. Drenica është e katërta me 18 pikë, kurse “Nikli” vazhdon

SUPERLIGA	
Llapi - Trepça '89	5-0
Drita - Prishtina	0-0
Drenica - Feronikeli	1-0
Të mërkurën takohen:	
13:30 Arbëria - Besa	
Ballkani - Gjilani (shtyhet)	

me rezultate zhgënjyese në këtë edicion të garave, duke u renditur në vendin e shtatë me 12 pikë. Në ndeshjen tjetër që është zhvilluar të martën në stadiumin “Zahir Pajaziti”, Llapi e ka shkatërruar Trepçën '89 (5-0). Skuadra në krizë të madhe, Llapi, ishte i pamëshirshëm për udhëtuesit nga Mitrovica. Dy gola në këtë ndeshje i realizoi Edon Sadiu, kurse nga një gol e shtuan Muhamet Hyseni, Elvis Prenqi dhe Adonis Aliu. Pas tri pikëve të reja, Llapi del në pozitën e nëntë me 8 pikë, kurse '89-shi zë vendin e gjashtë me 14 pikë. Sot (e mërkurë) nga ora 13:30 zhvillohet ndeshja në mes të Arbërisë dhe Besës së Pejës, kurse derbi në mes të Ballkanit dhe Gjilanit është shtyrë për një datë të pacaktuar.

SHKURT

Kullashi ndalet në rrethin e dytë në Evropianin U-23

Arbër Kullashi është ndalur në xhiron e dytë në Kampionatin Evropian U-23 të xhudos. Garuesi nga Kosova e fitoi duelin e parë kundër polakut Rdzmal, mirëpo ai u ndal në rrethin e dytë pasi u dorëzua përballë garuesit spanjoll Nieto Trinidad. Kosova, megjithatë, doli mirë nga kjo ngjarje, e cila u mbajt në Poreç të Kroacisë. Laura Fazliu e fitoi medaljen e bronzit në kategorinë 63 kilogramë, ndërsa ditë më parë e kishte fituar të argjendit në Evropianin U-21.

Lazio “blindon” Inzaghin

Presidenti i Lazios, Claudio Lotito dhe trajneri Simone Inzaghi kanë gjetur pajtimin për rinovimin e kontratës e cila i skadonte në qershor 2021. Inzaghi do të firmosë një kontratë të re në bazën e një milion eurove, pagë e cila do të rritet deri në tre milionë më 2023. Lotito me këtë lëvizje kërkon të sjellë pak qetësi në radhët e klubit, largon dyshimet mbi të ardhmen e trajnerit, me shpresë që ekipi i tij të rikthehet te rezultatet pozitive.

Beckhami e dëshiron Ramosin te Miami

David Beckham dëshiron që ta transferojë Sergio Ramosin tek Inter Miami vitin e ardhshëm, sipas raportimeve nga “Mundo Deportivo”. Mbrojtësi i Real Madridit ende nuk e ka nënshkruar kontratën e re me “mbretërit”, dhe ajo aktualja i skadon verën e ardhshme. Beckham po shpreson që ta sjellë Ramosin në ligën amerikane, por madrilenët besojnë fuqishëm se kapiteni i tyre legjendar do ta rinovojë kontratën.

Sloveni Rogliç sërish triumfon në Vuelta

Çiklisti sloven Primoz Rogliç ka fituar edicionin e 75-të të Vueltës së Spanjës, duke mbrojtur titullin e fituar vjet. Për shkak të pendemisë ky edicion u zhvillua me 18 etapa (jo 21), një turne që dhuroi emocione. Rogliç, 31 vjeç, bëri një paraqitje të mirë, duke e merituar fitoren. Në total, Rogliç dha kohën 72h46'12", duke lënë pas ekuadorianin Richard Carapaz (i dyti) dhe britanikun Hugh Carthy (i treti).

Tre lojtarë të Romës rezultojnë pozitivë me Covid-19

Rastet me koronavirus në shtëpinë e Romës po rriten. Pas Dzekos dhe portierit të rinjve, rezultuan pozitivë me Covid-19 edhe Federico Fazio, Davide Santon dhe Lorenzo Pellegrini.

Ish-mbrojtësi i Interit është stërvitur veçmas, për 10 ditë për shkak të një dëmtimi, ndërsa mbrojtësi argjentinas dhe mesfushori i kombëtares së kaltër ishin të dy në “Marassi”

për ndeshjen kundër Genoas. Testet e së shtunës kishin rezultuar negativë, ndërsa të hënën pozitivë. Fazio dhe Pellegrini do t'u nënshtrohen testeve nga kjo e martë ashtu si

pjesa tjetër e ekipit. Ky është një tjetër lajm i keq për verdhekuqtë, pasi Fonseca duhet të bëjë pa një tjetër titullar pas humbjes së kapitenit. Megjithatë, lajmi është se dy të tjerë të infektuar “për një

kohë të gjatë”, Calafiori dhe Diawara, kanë kaluar testet e përshtatshmërisë fizike dhe do të jenë në gjendje të ribashkohen me pjesën tjetër të skuadrës.

REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
 SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procesurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Suharekës ju fton në:

06.11.2020

REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MAJRE NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	54166	€

SHQYRTIM PUBLIK

(FAZA E II-të)

Për: Propozim Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028

Datë: 09.11.2020 deri më 23.11.2020

Vendi: Objekti i Komunës së Suharekës- Zyret e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim

Komuna e Suharekës, pas përfundimit të fazës së parë të shqyrtimit publik të "Propozim Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028", duke marrë për bazë situatën pandemike dhe kërkesat e shumta të qytetarëve që në pamundësi të jenë pjesë e shqyrtimit publik gjatë fazës së parë dhe pas miratimit nga ana e Ministrisë, shpall shqyrtimin publik edhe për 14 ditë të tjera para qytetarëve dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara apo që atakohen nga zhvillimi i komunës në tetë (8) vitet e ardhshme.

Dokumentin mund ta gjeni në linkun: <https://kk.rks-gov.net/suhareke/urbanizem/shqyrtimi-publik-ppzh-komunal-2020-2028/>

Shqyrtimi publik do të zgjas **14 ditë** nga data **09.11.2020 deri më 23.11.2020**, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, kërkesa apo sugjerime të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe korrektësi të plotë. Komentet mund të dorëzohen në mënyrë zyrtare, në mënyrë fizike në zyret e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim, apo përmes formës elektronike në urbanizmisuhareke@rks-gov.net

Kryetar i Komunës
 z. Bali Muharremaj



Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

1. Shykran (Xhelal) Rexhaj, Xheladin (Xhelal) Bruti, Salajdin (Xhelal) Bruti dhe Tyrkan (Xhelal) Shala, me adresë në Prizren, rr. "Behajdin Hallaqi" nr.26, janë bashkëpronar me pjesën prej nga 1/5 e pjesës ideale, të patundshmërisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813010-00464-13, në vendin e quajtur "Bela-voda", në sipërfaqe të përgjithshme prej 3333 m², Zona kadastrale Sërbicë e Epërme.

Nga pjesët e tyre ideale ofertojnë për shitje tërë pjesët me nga 1/5 përkatësisht sipërfaqen prej rreth 2666 m² të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 26.660 € (me shkronja: Njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro).

Prizren, 10.11.2020

Ofertuesit,
 Shykran Rexhaj
 Xheladin Bruti
 Salajdin Bruti
 Tyrkan Shala



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

GENERAL PROCUREMENT NOTICE (GPN)

Government of the Republic of Kosovo

Millennium Foundation of Kosovo (MFK)

The Government of the Kosovo has received grant funding of USD\$49 million (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to enable the Government of the Republic of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Threshold agreement, and it intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for contracts for goods, works and services.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the compact up-front, with no incremental or partial funding. When a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

The procurement program for this period will include the following:

Procurements for period November 2020 – December 2020

Procurement of Goods

In the Reliable Energy Landscape Project including:

DHM - Metering system supply & installing

Procurement of Works

In the Reliable Energy Landscape Project including:

Household Efficiency Retrofits (HER) Intervention Package - EE materials and products

AER -Apartment Building Efficiency Retrofits Sub-activity Works

Procurement of Services

In the Reliable Energy Landscape Project, Transparent Governance Project and Administration sector, including:

Software, Hardware, and TA in Communications & Outreach for the Public Access to Judicial Information Activity (Case Management Information System "CMIS")

Consultancy (Stakeholders workshops for Judicial Dig Data Challenge)

Procurement of Consultant Services IPP and Energy Efficiency Project Accelerator and Pipeline Development Consultant: Demand-Side Training, Firm-Level Engagement, and Marketing Strategy

Communication and Outreach for Judicial Data Challenge

Event Management for CMIS workshops and promotional activities

Consultants - Jury for Open Data Challenge

Dig Data Air Quality Awards Ceremony & Promotion and Events for the Energy Dig Data

Consultant to assist with activities WE Internship and Scholarship Program

Liaise and manage with potential host institutions in the energy sector with activities WE Internship and Scholarship Program.

Outreach activities and the launch event for the Internship Program

Data Quality Review for Reliable Energy Landscape Project and Transparent Governance Project

Consultancy (Open Data Training of Gov't/CSO's/Private Sector) for Energy Dig Data

Contracts for goods, works and services financed under the program will be implemented according to the principles, rules and procedures set out in the MCC Program Procurement Guidelines, which can be found at the MFK website.

The procurement is open to all bidders from eligible source countries as defined in the MCC Program Procurement Guidelines.

Specific procurement notices for contracts to be tendered under the competitive bidding procedures and for consultant contracts will be announced, as they become available, on the MFK website: <https://millenniumkosovo.org/>, United Nations Development Business (UNDB): <http://www.devbusiness.com/>, Development Gateway Market (dgMarket): <http://www.dgmarket.com/>, in local newspapers, and other media outlets as appropriate.

Interested eligible contractors and consultants who wish to be included on the mailing list to receive a notice of advertisements should subscribe on the MFK website under the link: <https://millenniumkosovo.org/subscribe/>, type your email and select under the list *Procurement*, or those requiring additional information, should contact:

Procurement manager:	Arton Çitaku – MFK Procurement Manager
c/o:	Millennium Foundation of Kosovo
Address:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Telephone:	+ 383 38 752 110
Email:	procurement@millenniumkosovo.org

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Hajzer Gashi B. I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 811245572 dhe nrb. 70751917 me seli në Klinikë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

